



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:096444  
Datë: 26.04.2023  
Numri i dokumentit: 04223938

**SCC-10-0105**

*Ankuesi*

**B M**

*Përfaqësuar nga av H P Gjakovë.*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese, Hasim Sogojeva dhe Gazmend Sylaj gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 19 prill 2023, me shumicë votash, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), jep pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditësit B M ndaj të paditurës Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) dhe se padia e paditësit, **KONSTATOHET e tërhequr.**

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 26 maj 2010, përfaqësuesi i paditësit, parashtroj Padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë. Palët ndërgjyqës kanë lidhur kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë – banesës në pronësi shoqërore e evidentuar te i padituri nën nr. 473 e dt. 17.06.1991. Blerësi ka qenë i obliguar që pagesën e asaj paluajtshmërije – banese ta paguan në kohë zgjatje prej 35.6 vitesh në këste mujore. Me 10.12.1991 paditësi i ka paguar të paditurit tërë çmimin kushtetues për banesën e blerë sipas kontratës së sipërshënuar, për çka i padituri ka qenë i obliguar që pas kësaj pagese me të paditurin të lidhin Aneks kontratën rreth pagesës definitive të çmimit kushtetues, sipas paditësit edhe përkundër faktit se paditësi e ka përmbushur obligimin kontraktues në tërësi ndaj të paditurit, i njëjti ende paditësit nuk ia ka njohur të drejtën

pronësore në paluajtshmërinë e sipërshënuar. Gjykatës i propozon që me Aktgjykim të vërtetohet se paditësi B M nga Gjakova është pronarë i paluajtshmërisë - banesës e cila gjindet në Gjakovë, banesa nr.659, kati i I – të në sipërfaqe prej 94.30m2, për çka e paditura Sh. “E” në Gjakovë detyrohet të ja njoh paditësit këtë të drejtë si dhe të paguaj shpenzimet procedurale e krejt këto në afatin prej 15 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Së bashku me padi ai ka bashkëngjitur padinë në gjuhën angleze, autorizimin me të cilin e autorizon av. H P i dt. 04.06.2009, kopjen e kontratës mbi shitjen e banesës me nr. 473 e dt. 17.06.1991, kopjen e njoftimit drejtuar AKP-së e dt. 25.05.2010, pagesën e taksës gjyqësore.

Me dt. 16 dhjetor 2010, gjykata lëshon një Aktvendim më të cilin e ndërpret procedurën deri në zgjidhjen e statusit juridik të “E” se e njëjta a është NSh, nëse është a do të jetë nën administrimin e AKM-së dhe e njëjta a mund të jetë si palë e paditur në këtë procedurë.

Me dt. 08 shkurt 2023, e paditura AKP ka parashtuar përgjigje në padi duke theksuar se e njofton gjykatën se pala paditëse kërkesën e saj për blerjen e banesës e ka realizuar pranë Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore që gjendet në AKP të cilin Bordi i Drejtorëve i AKP-së e ka aprovuar me vendimin e saj nr. ref. BD-173/31 kërkesën e paditësit për blerjen e banesës me nr. KB-1501/18 me dt. 30.11.2022. Më tutje në mbrojtjen e AKP-së theksohet se paditësi edhe këtë të drejtë e ka realizuar përmes nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me AKP-në me dt. 29.12.2022. Në fund AKP i propozon gjykatës që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të tyre të merr Aktgjykim me të cilin të refuzohet kërkesa e paditësit B M nga Gjakova, i përfaqësuar nga av. H P për shkak se çështja është jo lëndore, paditësi objektin e kërkesës e ka realizuar pranë komisionit për banesa në AKP. Bashkë me përgjigjen ajo ka bashkëngjitur kopjen e Vendimit me nr. Ref. BD – 173/31, kopjen e Kontratës për Shitblerjen e Banesës me nr. 5496 e datës 29 dhjetor 2022.

Me 13.03.2023 përfaqësuesi i paditësit ka dorëzuar një parashtrësë me të cilën ka tërhequr padinë në këtë çështje kontestuese duke u bazuar në vendimin e të paditurës nr. Ref. BD-173/31 të dt. 30.11.2022 dhe Kontratës mbi shitblerjen e banesës e cila ka qenë objekt i padisë së paditësit .

### **Arsyetimi ligjor**

Neni 34 pika 1 i Ligjit për DHPGJS parasheh që, paditësi mund ta tërheq padinë e tij në çdo kohë me pajtimin e DHPGJS. Me dhënien e pëlqimit të saj gjykata merr parasysh interesin e të gjitha palëve tjera.

Gjykata mori parasysh interesin e palëve në këtë procedurë dhe vendosi të japë pëlqimin për tërheqjen e padisë. Më tutje Gjykata gjeti se me që paditësi të drejtën e tij e ka realizuar përmes nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me AKP-në me dt. 29.12.2022 dhe në këtë mënyrë padia si e tillë tani është pa objekt.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të Aktvendimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesën e parashtruar.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Padia duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Hajrie Shala** Gjyqtare kryesuese

**Hasim Sogojeva** anëtarë

**Gazmend Sylaj** anëtarë

Shtojcë: Aktvendimit i bashkëngjitet mendimi mospajtues i anëtarit të kolegjit i cili është i nënshkruar dhe është pjesë e dosjes së lëndës.